



**Kompania Rajonale e Ujësjesit**  
*Regional Water Supply Company*  
*Regionalna vodovodna kompanija*

---

# **Plani i Menaxhimit të Llumit të ITUN – Gjakovë**



**Dhjetor 2022**

# Përmbajtja

Hyrje .....	1
1. Korniza e projektit.....	1
1.1. Procesi i trajtimit në ITUN.....	1
1.1.2. Përshkrimi i njësive të procesit.....	3
2. Parimet e menaxhimit të llumit .....	6
2.1. Kuadri ligjor për asgjësimin e llumrave të ujërave të ndotura.....	7
2.1.1. Kuadri ligjor Evropian .....	7
2.1.2. Kuadri ligjor Kombëtar.....	7
2.1.3. Detyrimet e KRU Gjakova për përdorimin e llumit të ujërave të ndotura në bujqësi.....	8
2.1.4. Detyrimet e përdoruesve të llumit të ujërave të ndotura .....	9
2.2. Institutet teknike dhe aftësia analitike për monitorim .....	9
2.3. Prodhimi i llumit.....	10
2.3.1. Llumi i prodhuar në ITUN Gjakova .....	10
3. Koncepti për largimin e llumit të ujërave të ndotura .....	11
3.1. Partnerët e mundshëm lokalë .....	11
3.2. Deponimi i llumit.....	12
3.3. Përdorimi i llumit në bujqësi.....	13
3.4. Deponimi i llumit në deponi .....	13
4. Vlerësimet ekonomike.....	14
4.1. Kostot e asgjësimit.....	14
4.2. Kostot e investimit .....	16
5. Funkionimi praktik i asgjësimit të llumit të ITUN Gjakova .....	17
5.1. Përgjegjësitë dhe aktivitetet e KRUGJ gjatë aplikimit të llumit .....	17
5.2. Kërkesat për ruajtjen e llumit.....	18
5.3. Kërkesat për transportin e llumit.....	18
5.4. Marketingu i llumit .....	19
5.4.1. Strategjia e marketingut .....	19
5.4.2. Shitja e llumit.....	20
Përmbledhja .....	21
SHTOJCA.....	22
Shtojca 1. Rezultatet e analizave të llumit të ITUN Gjakova .....	22
Shtojca 3. Aprovimi nga MMHP për deponimin e llumit të ITUN Gjakova në deponinë ePrizrenit.....	27
Shtojca 4. Leja për deponim të llumit dhe përcaktimi i tarifës nga Kompania përMenaxhimin e Deponive të Kosovës.....	29
Shtojca 5. Kontrata me KRU “Çabrati” për transportimin e llumit në deponinë e Prizrenit. ....	30

## **Lista e Tabelave**

<i>Tabela 1. Të dhënat e Influentit për projektimin e ITUN - Gjakova .....</i>	<i>2</i>
<i>Tabela 2. Shfrytëzimi i mundshëm i llumit të ujërave të ndotura.....</i>	<i>6</i>
<i>Tabela 3. ITUN Gjakova - Kalkulimet e procesit për llumin e çujëzuar të deponuar në shtretërit e llumit .</i>	<i>10</i>
<i>Tabela 4. Partnerët e mundshëm lokal si pika të daljes së llumit të ITUN Gjakova.....</i>	<i>11</i>
<i>Tabela 6. Pasqyrë e kostove për asgjësimin mbetjeve nga grilat, rërës, yndyrës dhe llumit.....</i>	<i>14</i>
<i>Tabela 7. Vlerësimi i kostos së përdorimit të llumit për bujqësi dhe deponimi në deponi.....</i>	<i>15</i>
<i>Tabela 8. Kostot e investimit për mbetjet nga grilat, rërën, yndyrën dhe llumin e ITUN Gjakova.....</i>	<i>16</i>
<i>Tabela 9. Plani i veprimit për ripërdorimin e llumit të ITUN në bujqësi.....</i>	<i>17</i>

## **Lista e Figurave**

<i>Figura 1. Njësia për çujëzimin e llumit.....</i>	<i>5</i>
<i>Figura 2. Llumi pas çujëzimit dhe shtretërit e tharjes .....</i>	<i>5</i>

## **Lista e Shkurtesave**

e.p Ekuivalent i Popullsisë

IBK Instituti Bujqësor i Kosovës

ITUN Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura

KMDK Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës

KRUG Kompania Rajonale e Ujësjetësimit Gjakova

OMPM Opsioni më i Mirë i Praktikueshëm Mjedisor

SHBO Shpenzimi Biologjik i Oksigjenit

SHKO Shpenzimi Kimik i Oksigjenit

UA Udhëzimi Administrativ

## Hyrje

Me vendimin Nr. KNMU/V/04/2022 të datës 16 Shkurt 2022, Këshilli Ndërmintor për Ujëra (KNU) i ka obliguar Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU-të) që t'i hartojnë planet për menaxhimin e llumit nga procesi i trajtimit të ujërave të ndotura. Afati për hartimin e këtyre planeve nga KRU-të, me këtë vendim është përcaktuar të jetë 31 Dhjetor i vitit 2022.

Bazuar në këtë vendim e me qëllim të planifikimit të menaxhimit adekuat dhe afatgjatë të llumit nga procesi i trajtimit të ujërave të ndotura të kanalizimit, është iniciuar hartimi i këtij plani.

Ky plan është i bazuar në dokumentin “*Koncepti për Menaxhimin e Llumit*” i hartuar në vitin 2016-2017 në kuadër të projektit “Largimi i Ujërave të Ndotura në Jug-Perëndim të Kosovës Faza III, Gjakovë”. Ky Koncept për Menaxhimin e Llumit ka filluar të përpilohet në vitin 2016 nga komponenti i Masave Shoqëruese si pjesë e Konsulencës, ndërsa në Tetor 2017, është miratuar edhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

Pas përfundimit të fazës së komisionimit të ITUN Gjakova (Mars-Qershor 2022) ky Koncept është përditësuar duke u bazuar në gjendjen aktuale dhe kushteve lokale për menaxhim të llumit, dhe si i tillë është finalizuar në Dhjetor 2022.

## 1. Korniza e projektit

Ky projekt u zbatua në kuadër të Bashkëpunimit Zhvillimor ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë përmes Bankës Zhvillimore KfW dhe Qeverisë Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO) dhe Komunës së Gjakovës.

Korniza financiare e këtij projekti është gjithsej 16.80 milion euro (neto) e ndarë në:

- Granti nga SECO prej 7.60 mil EUR;
- Granti nga KfW-së prej 6.00 mil EUR;
- Kontributi vetanak i Komunës së Gjakovës prej 3.20 milion EUR për blerje/shpronësim të parcelës ku është ngritur ITUN-i, të drejtën e kalimit për kolektorët kryesore dhe obligime tjera financiare; Gjithashtu, përfshin fonde për punë të paparapara dhe investimet e tjera plotësuese

### 1.1 Procesi i trajtimit në ITUN

Procesi i trajtimit të ITUN-GJ është proces alternativ i trajtimit: Sistem i Ajrimit të Tejzgjatur. Kjo do të thotë se ITUN është projektuar me qëndrueshmëri të lartë të llumit (Koha e Qëndrimit të Llumit > 25 ditë) duke siguruar kështu stabilizimin e llumit që do të thotë ndaljen e fermentimit natyral të tij. Llumi i prodhuar trajtohet lehtësisht dhe mund përdoret në bujqësi, si dhe parandalohen emetimet e aromës.

Kështu që shtretërit për tharjen e llumit mund të përdoren po ndonjë problem për këtë qëllim.

Trajtimi i ujërave të ndotura përfshin:

- Trajtimin paraprak;
- Trajtimin dytësor me rezervuarë oksidimi dhe
- Përpunimi i llumit.

Trajtimi dytësor realizohet me anë të një sistemi të aktivizuar me ajrim të tejzgatur dhe me stabilizim të mëpasshëm të llumit. Heqja e nutrientëve planifikohet të bëhet gjatë fazës së ardhshme (faza B).

Sistemi i trajtimit të llumit përbëhet nga:

- Rezervuari për mbajtjen e llumit,
- Sistemi mekanik i trashjes-çujëzimit,
- Shtretërit e tharjes së llumit për deponim.

Ky sistem është projektuar për të siguruar efikasitetin e nevojshëm të trajtimit dhe gjithashtu stabilizimin e llumit me kosto të ulët operacionale dhe funksionim të thjeshtë.

ITUN është i projektuar në dy faza:

- Projekti i tanishëm: Faza A për vitin 2025 për t'i shërbyer një popullsie ekuivalente prej 29.080 e.p;
- Projekti për zgjerim në të ardhmen: Faza B për vitin 2040 për t'i shërbyer një popullsie ekuivalente prej 68.278 e.p;

Tabela 1. Të dhënat e Influentit për projektimin e ITUN - Gjakova.

Parametrat	Njësia	Faza A (2025)	Faza B (2040)
Ekivalenti i popullsisë	banorë	<b>26.436</b>	<b>62.071</b>
Konsumi specifik i ujit	l/ban-d	175	150
Përqindja e furnizimit me ujë në rrjetin e kanalizimeve	%	90%	90%
Rrjedha shtesë e ujërave të ndotura jo-shtëpiake	%	20%	20%
Rrjedha specifike (shtëpiake dhe jo-shtëpiake)	l/ban-d	189	162
Ngarkesa specifike SHKO	g/ban-d	120	120
Ngarkesa specifike SHBO	g/ban-d	60	60
Ngarkesa specifike SS (grimcave të pezulluara)	g/ban-d	70	70
Ngarkesa specifike TN (Azotit Total)	g/ban-d	11,0	11,0
Ngarkesa specifike TP (Fosforit Total)	g/ban-d	2,0	2,0
% ngarkesës shtesë së ndotjes jo-shtëpiake (SHKO, SHBO, TN, TSS dhe TP)	%	10%	10%
<b>Ekivalenti i popullsisë (bazuar në 60grSHBO)</b>	<b>e.p.</b>	<b>29.080</b>	<b>68.278</b>
<b>NGARKESA E NDOTJES</b>			

Parametrat	Njësia	Faza A (2025)	Faza B (2040)
Shpenzimi Kimik i Oksigjenit SHKO	kg/d	3490	8193
	mg/l	367,6	582,0
Shpenzimi Biologjik i Oksigjenit SHBO	kg/d	1745	4097
	mg/l	183,8	291,0
Grimcat e Pezulluara, SS	kg/d	2036	4779
	mg/l	214,4	339,5
Azoti Total, TN	kg/d	320	751
	mg/l	33,7	53,4
Fosfori Total TP	kg/d	58	137
	mg/l	6,1	9,7

### 1.1.2 Përshkrimi i njësive të procesit

Më poshtë, janë përshkruar shkurtimisht njësitë e procesit ku do të grumbullohet materiali për asgjësim.

#### **Trajtimi primar**

**Grilat e trasha.** Ujërat e ndotura në hyrje rrjedhin me anë të gravitetit nëpërmjet një gypi DN600 dhe futen në rezervuarin kryesor. Pastaj rrjedha ndahet në dy kanale ku janë instaluar pajisjet automatike të grilave të trasha (distanca mes grilave 50mm). Funksonimi i grilave kontrollohet nëpërmjet sensorëve të nivelit (niveli i ujit para dhe pas grilave) dhe/ose kohëmatësit.

**Njësia e grilave të imëta.** Nëpërmjet pompave hyrëse uji do të shkarkohet në një kanal për të kaluar me pas tek grilat e imëta. Pastrimi i ujit të ndotur nëpërmjet grilave të imëta do të kryhet nga dy grila automatike të instaluar (distanca mes grilave 6mm). Mbetja e ndarë nga grilat nëpërmjet një gypi transportues kalon tek pajisja për larje dhe presim, duke u shkarkuar me pas në kontejnerët përkatës.

**Njësia për largimin e rërës dhe yndyrës.** Ujërat e ndotura pas pastrimit përmes grilave të imëta kalojnë tek rezervuari për largimin e rërës dhe yndyrës. Ky rezervuar është i ndarë në dy pjesë ku bëhet ajrimi i cili sigurohet nga tre ventilatorë me kapacitet 210 m<sup>3</sup>/h secili, me ç ‘rast rëra do kalojë në pjesën e poshtme të rezervuarit kurse yndyra shtresohet në pjesën e sipërme të rezervuarit. Në një urë lëvizëse janë të instaluar dy pompa zhytëse për mbledhjen e rërës dhe mbledhësi i yndyrës.

#### **Trajtimi sekondar**

Trajtimi sekondar apo trajtimi biologjik kryhet me anë të metodës me ajrim të tej zgjatur - llum aktiv me heqjen e azotit (Nitrifikimi – Denitrifikimi) dhe stabilizim të llumit me **SRT** (koha e qëndrimit të llumit) të lartë. Gjatë këtij procesi bëhet heqja e mbetjeve organike të biodegradueshme.

## **Trajtimi i llumit**

### **Rezervuari i mbajtjes së llumit**

Llumi i tepërt transferohet në rezervuarin mbajtjes të llumit me kapacitet prej 450 m<sup>3</sup> nëpërmjet pompave të llumit të tepërt të instaluara në stacionin e pompimit të llumit të aktiv. Në rezervuar është i vendosur një ajruer i cili ndikon në parandalimin e krijimit të kushteve septike dhe redukton sasinë e fosforit.

### **Trashja mekanike e llumit – Çujëzimi**

Nga rezervuari i mbajtjes llumi kalon tek pajisja për çujëzim – Centrifuga.

Çujëzimi i llumit bëhet nëpërmjet centrifugës me kapacitet 40 m<sup>3</sup>/h, ndërsa një e dytë me të njëjtin kapacitet do të instalohet në të ardhmen (për Fazën B). Në mënyrë që të përshpejtohet procesi i çujëzimit, dozohet tretësira e polimerit. Për këtë qëllim është i instaluar një sistem automatik i përgatitjes së tretësirës së polimerit. Sistemi është projektuar për të përgatitur një tretësirë polimeri me një përqendrim 2 g/l (0.2%) dhe për një dozë maksimale prej 10 g Polimer për kg SS. Tretësira e polimerit dozohet nëpërmjet një pompe dozimi në një rezervuar flokulimi ku bëhet përzierja me llum dhe kjo përzierje më pas kalon në centrifugë. Ekzistojnë dy pompa të polimerit, njëra në funksion dhe tjetra në gjendje gatishmërie. Një sistem i ngjashëm i përgatitjes dhe dozimit të polimerit do të instalohet shtesë në të ardhmen, për Fazën B.

Llumi i çujëzuar shkarkohet në kontejnerin përkatës me anë të shiritit transportues i cili është i instaluar nën centrifugë. Llumi i çujëzuar i shkarkuar në kontejner, me anë të mjetit transportues shkarkohet në shtretërit e tharjes së llumit.





*Figura 1. Njësia për çujëzimin e llumit.*

### **Shtretërit për tharjen e llumit**

Me qëllim të ruajtjes së llumit, si dhe për një mbështetje në njësinë mekanike të çujëzimit, janë të ndërtuar pesë shtretër tharje që funksionojnë paralelisht, të aftë për të trajtuar prodhimin e plotë të llumit për Fazën A dhe 40 % të llumit të prodhuar në Fazën B. Çdo shtrat tharjeje ka një gjerësi prej 16.5 m dhe një gjatësi prej 62 m, me një sipërfaqe totale prej rreth 5000 m<sup>2</sup>.

Shtretërit e tharjes janë në formë drejtkëndëshe, prej betoni, me fund të pjerrët me një pjerrësi adekuate prej të paktën 5%, duke e çuar ujin e ndarë në kanalën e kullimit. Lartësia totale e çdo shtrati është 0.8m ku ndodhen tre shtresa me rërë dhe zhavorr të madhësisë së duhur. Llumi shtrihet mbi nivelin e sipërm dhe lartësia maksimale e llumit të lagësht do të jetë 0.3m. Heqja e llumit nga shtretërit bëhet me anë të ekskavatorit sapo të jetë tharë. Shtretërit e tharjes janë të mbuluar me panele plastike transparente ose gjysmë transparente.



*Figura 2. Llumi pas çujëzimit dhe shtretërit e tharjes.*

## 2. Parimet e menaxhimit të llumit

Për të përcaktuar opsionin më të mirë dhe më praktik të menaxhimit të llumit, në aspektin mjedisor (OMPM) janë të nevojshme studime strategjike, që nënkupton një qasje e integruar dhe holistike për planifikimin e trajtimit dhe ripërdorimit ose asgjësimit që përshtatet me kushtet lokale. OMPM merr parasysh të gjitha çështjet që lidhen me praktikueshmërinë, implikimet mjedisore, sociale dhe ekonomike të opsioneve të mundshme të trajtimit dhe asgjësimit në rrethanat lokale. Kjo siguron një qasje objektive për përcaktimin e bilancit më të mirë të kostove, përfitimeve dhe ndikimeve, dhe për të ofruar zgjidhje më të qëndrueshme.

Në përputhje me konceptin ndërkombëtar të hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve, prioritet për menaxhimin e llumit është ripërdorimi, kudo që është e mundur, për të rritur vlerën e burimeve të këtyre produkteve. Kjo qasje është miratuar në politikat kombëtare të menaxhimit të mbetjeve duke futur masa që parandalojnë ose dekurajojnë asgjësimin me anë të ndalimit, vendosjes së standardeve të rrepta teknike ose me instrumente ekonomike (p.sh. taksa mbi deponimin e mbetjeve, etj.).

Opsionet e mundshme që zakonisht konsiderohen për ripërdorim ose asgjësim të llumit janë cekur në tabelën 2:

*Tabela 2. Shfrytëzimi i mundshëm i llumit të ujërave të ndotura.*

Në bazë toke	Në bazë produkti	Rikuperim i energjisë	Deponim
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Bujqësi</li> <li>➤ Zona të gjelbëruara</li> <li>➤ Pylltari</li> <li>➤ Bonifikim të tokës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Prodhim i kompostove</li> <li>➤ Materiale ndërtimore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Bashkë-djegia (prodhimi i energjisë/nxehtësi së, prodhimi i çimentos)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Deponimi i llumit ose hirit pas djegies</li> </ul>

Normalisht, opsioni i preferuar dhe i zakonshëm i menaxhimit të llumit është përdorimi i dobishëm në tokë, veçanërisht për prodhime bujqësore. Ky konsiderohet gjerësisht si opsioni më i qëndrueshëm me kusht që cilësia e llumit dhe përdorimi i tij të kontrollohet, dhe fermerët janë të gatshëm të përdorin llumin. Përdorimi në këtë mënyrë siguron që lëndët ushqyese dhe lëndët organike të riciklohen, ku do të rrisë prodhimin e të korrave, do të reduktojë përdorimin e plehrave kimike duke përmirësuar vetitë fizike të tokës në lidhje me kultivueshmërinë e saj, ruajtjen e lëndëve ushqyese dhe kapacitetin mbajtës të lagështisë.

Djegia e llumit është një proces trajtimi për minimizim masiv, preferencialisht me rikuperimin e energjisë dhe mund të miratohet kur mundësitë për përdorimin ose asgjësimin e llumit janë apo nuk janë të kufizuara.

## **2.1. Kuadri ligjor për asgjësimin e llumrave të ujërave të ndotura**

### **2.1.1. Kuadri ligjor Evropian**

Si një vend kandidat potencial për anëtarësim në Bashkimin Evropian, rregulloret mjedisore janë zhvilluar dhe përshtatur në Kosovë për të harmonizuar ligjet dhe rregulloret e BE-së. Prej tyre, vetëm disa kanë lidhje direkte ose indirekte për menaxhimin e llumit. Direktiva e mëposhtme e BE-së është e zbatueshme për largimin e llumit të ujërave të ndotura në Kosovë në lidhje me përdorimin në bujqësi:

1. Direktiva e Këshillit të BE-së 91/676/EEC e datës 12 dhjetor 1991 lidhur me mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratat nga burimet bujqësore.
  2. Direktiva e Këshillit të BE-së 2000/76/EC e datës 4 dhjetor 2000 mbi djegien e mbetjeve
- Direktiva e Këshillit 91/676/EEC synon të mbrojë ujërat nga ndotja e shkaktuar nga nitratat nga burimet bujqësore nëpërmjet një sërë masash të ngarkuara për Shtetet Anëtare. Këto masa kanë të bëjnë me monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, përcaktimin e zonave të ndjeshme, futjen e kodeve të praktikave të mira bujqësore, miratimin e programeve të veprimit dhe vlerësimin e veprimeve të zbatuara. Duhet të përmendet se Ligji për Ujërat e Kosovës - Ligji Nr. 04/L-147 (2013) nuk e transponon plotësisht këtë Direktivë të BE-së 91/676/EEC.

### **2.1.2. Kuadri ligjor kombëtar**

Ligjet e mëposhtme kombëtare dhe udhëzimet administrative janë të zbatueshme për asgjësimin e llumit të ujërave të ndotura, mbetjet nga grilat, rërës dhe yndyrës:

1. Ligji për Mbeturina - Ligji Nr.04/L-060 (2012)
2. Ligji për Mbetjet - Ligji Nr. 02/L-30 (2005) - Shtojca 01 (Katalogu Evropian i Mbetjeve)
3. Ligji për Ujërat e Kosovës - Ligji Nr. 04/L-147 (2013)
4. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit - Ligji Nr. 03/L-025 (2009)
5. Ligji për Tokën Bujqësore - Ligji Nr. 02/L-26 (2005)
6. Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja – Ligji nr. 03/L-160 (2010)
7. Udhëzimi Administrativ nr. 29/2014 për Menaxhimin e Llumit nga Trajtimin e Ujërave të Ndotura
8. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2008 për Administrimin e Mbeturinave të Rrezikshme
9. Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2017 e Menaxhimit të Deponive të Mbeturinave
10. Udhëzimi Administrativ Nr. 28/2014 Për Zonat e Mbrojtura Sanitare
11. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015 për Listën e OECD për Mbeturina

12. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2017 Për Lejen Mjedisore,

13. Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2014 Për Licencën për Menaxhimin e Mbeturinave

### **2.1.3. Detyrimet e KRU Gjakova për përdorimin e llumit të ujërave të ndotura në bujqësi**

Me qëllim të shmangies së çdo rreziku të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit gjatë përdorimit të llumit të ITUN Gjakova në bujqësi, kompania është e detyruar që :

- Të informojë çdo përdorues për rreziqet e përdorimit të llumit të ujërave të ndotura në bujqësi dhe rastet kur përdorimi i llumit të ujërave të ndotura në bujqësi është i kufizuar. KRUGJ duhet të përgatisë një fletë të dhënash që përmban këtë informacion dhe çdo përdorues i llumit duhet të konfirmojë duke nënshkruar këtë fletë të dhënash se ai është informuar nga KRUGJ dhe se ai e ka kuptuar informacionin.
- Të përcaktojë sasinë maksimale të llumit të shprehur në ton / mbetje të thatë që mund të përdoret në sipërfaqen e tokës për njësi gjatë një viti duke marrë parasysh kërkesat e UA 29/2014 në lidhje me kulturat e kultivuara (neni 5 i UA 29/2014).
- Të analizohet vazhdimisht llumi i ujërave të ndotura sipas udhëzimeve të paraqitura në Aneksin 4 dhe 6 të UA 29/2014 (neni 5 & 9 i UA 29/2014) dhe monitorimi i përqendrimit të vlerave të lejuara të metaleve të rënda në llum sipas Aneksit 2 & 3. të UA 29/2014 për të siguruar që vlerat e lejuara nuk do të tejkalohen.
- Të analizohet llumi të paktën çdo gjashtë muaj.
  - Kur ndodhin ndryshime në karakteristikat e ujërave të ndotura gjatë trajtimit, frekuenca e analizave duhet të jetë më e shpeshtë. Nëse rezultatet e analizave nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme gjatë një viti të plotë, atëherë llumi duhet të analizohet të paktën një herë në vit.
- Të ofrojë rregullisht informacionin e mëposhtëm për llumrat e ujërave të ndotura për përdoruesit (neni 6 i UA 29/2014):
  - Mbetja e thatë, mbetja organike;
  - vlera e pH;
  - Përqendrimi i azotit dhe fosforit;
  - Përqendrimi i kadmiumit, bakrit, nikelit, plumbit, zinkut, merkurit, kromit;
- Të sigurojë dhe të mbajë një regjistër të paktën deri në 10 vjet me të dhënat e mëposhtme (neni 10 i UA 29/2014):
  - Sasia e llumit të prodhuar dhe të furnizuar për përdorim në bujqësi;
  - Përbërja e duhur e llumit në përputhje me parametrat e vendosur sipas aneksit 4 i UA 29/2014;
  - Lloji i trajtimit të kryer
  - Emrat dhe adresat e përdoruesve të llumit dhe vendndodhjen ku përdoret llumi.
- Të përgatitet një raport vjetor dhe të dorëzohet në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, raporti përmban informatat në vijim (neni 13 i UA 29/2014):
  - Sasia e llumit të prodhuar, të trajtuar dhe të përdorur në bujqësi;
  - Përbërja dhe veçoritë e llumit sipas raporteve të rezultateve të analizës së llumit;
  - Personi, adresa e përdoruesve të llumit dhe zona/parcela kadastrale ku është përdorur llumi.

#### **2.1.4. Detyrimet e përdoruesve të llumit të ujërave të ndotura**

Me qëllim që të shmanget rreziku i dëmtimit të shëndetit të njeriut dhe mjedisit kur llumi i ujërave të ndotura të ITUN Gjakova do të përdoret në bujqësi, përdoruesit janë të obliguar:

- Të sigurohet që përmbajtja e metaleve të rënda në tokë duhet të jetë konsistente dhe të mos kalojë vlerat kufitare të përqendrimit të metaleve të rënda të përcaktuara në Aneksin 1 të UA 29/2014  
- Për këtë qëllim, KRUGJ do të vendosë se çfarë lloj testesh duhet të kryhen, duke marrë parasysh të dhënat shkencore në dispozicion për karakteristikat dhe homogjenitetin e tokës (Shtojca 5 e UA 29/2014).
- Të analizojë dheun në të cilën përdoret llumi i ujërave të ndotura sipas udhëzimeve të paraqitura në Aneksin 5 dhe 6 të UA 29/2014 (neni 12 i UA 29/2014) dhe të monitorojë përqendrimin e vlerave kufitare të metaleve të rënda në tokë sipas Shtojcës 1. të UA 29/2014 për të siguruar që vlerat kufitare nuk do të tejkalojnë;  
- Frekuenca e analizës së dheut varet nga përqendrimi i metaleve të rënda në tokë përpara përdorimit të llumit. Informacioni rreth sasisë dhe përbërjes së llumit të përdorur dhe çdo faktor tjetër relevant do të regjistrohet nga KRU Gjakova dhe do t'u ofrohet përdoruesve të llumit.
- Të kontrollohet çdo 5 vjet për çdo parcelë individuale të kultivuar me kultura të ndryshme mbi aftësinë prodhuese të tokës bujqësore me qëllim të mbrojtjes (mbi-plehërimit), ruajtjes dhe përmirësimit të karakteristikave kimike, fizike dhe biologjike të tokës bujqësore kultivuese dhe sigurimit të përdorimit të duhur të plehrave minerale dhe organike (si llumi i ujërave të ndotura) (Neni 22 i Ligjit për Tokën Bujqësore - Ligji Nr. 02/L-26 dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 38/2006 mbi:

*Kontrolli i Fertilitetit të Tokës Bujqësore; neni 4); në nenin 5 të UA nr. 38/2006 jepen parametrat e analizës për përdorime të ndryshme të tokës.*

Duhet përmendur se ky detyrim ndoshta mund të pengojë ose ngadalësojë procesin e fillimit të përdorimit të llumit në bujqësi nga fermerët vendas. Prandaj, rekomandohet që Komuna e Gjakovës të bashkë financojë analizimin laboratorit të cilësisë së dheut , veçanërisht në fillim, për të inkurajuar fermerët për ripërdorimin e llumit në bujqësi.

#### **2.2. Institutet teknike dhe aftësia analitike për monitorim**

Meqenëse KRUGJ si prodhues i llumit do të kërkojë që shërbimet në lidhje me analizat e domosdoshme të jenë në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e llumit, një anketë e instituteve teknike në Kosovë është ndërmarrë në vitin 2017 për të përcaktuar fushat e tyre të ekspertizës dhe aftësive analizuuese. Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë dhe laboratorit privat “Agrovet” në Prishtinë janë identifikuar si laboratorë potencialë të pavarur për analizimin e llumit të ujërave të ndotura.

Instituti i Bujqësisë i Kosovës (IBK) në Pejë, si institucion publik huluntues, i përket Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Departamenti i laboratorit të analizave është

mjaft i pajisur mirë për analiza të dheut dhe pesticideve dhe analizon rreth 3,500 mostra/vit. Pajisjet teknike janë në dispozicion për analizimin e përqendrimit të lëndëve ushqyese (azoti dhe fosfori) dhe metalet e rënda (kadmiumi, bakri, nikeli, plumbi, zinku, zhiva, kromi) në mostrat e tokës, llumit dhe ujit.

Laboratori privat “AGROVET” është laborator për testimin e mbetjeve të tokës dhe pesticideve në Prishtinë. Laboratori është akredituar nga DAK më 24 dhjetor 2008 dhe punon sipas standardit ndërkombëtar ISO/IEC 17025: 2005 (specifikon kërkesat e përgjithshme për kompetencën për të kryer teste dhe/ose kalibrime, duke përfshirë marrjen e mostrave) në mënyrë që të ofrojë rezultate cilësore të matjeve.

Për të vlerësuar analitikisht kualitetin e llumit pas komisionimit të ITUN, KRUGJ ka hapur tender publik në verën e vitit 2022. Tenderi përfshinte analiza laboratorike të parametrave sipas UA 29/2014 ANEKSI 4 për Menaxhimin e Llumit nga Trajtimi i Ujërave të Ndotura dhe UA 08/2017 për Menaxhimin e Deponimit të Mbeturave. Kontrata iu dha laboratorit privat Horn & Co. Analytics Gn. Analizimi i ekzekutuar i llumit të ujërave të ndotura nuk zbuloi ndonjë anomali në mostrën e llumit nga ITUN Gjakova. Sasitë e metaleve të rënda janë shumë nën vlerat kufitare (shih Shtojcën 1).

## 2.3. Prodhimi i llumit

Meqenëse ITUN Gjakova u vu në funksion vetëm disa muaj më parë, si bazë për llogaritje janë marr parasysh parametrat e projektimit.

### 2.3.1. Llumi i prodhuar në ITUN Gjakova

Llumi i ujërave të ndotura, një material gjysmë i ngurtë, prodhohet si nënprodukt gjatë trajtimit të ujërave të zeza dhe të ndotura komunale. Llumi tashmë trajtohet biologjikisht ku stabilizohet me anë të procesit të trajtimit me ajrim të tej zgjatur, që do të thotë se ndalet fermentimi natyror i llumit, nuk shfaqet erë dhe patogjenët hiqen. Llumi çujëzohet mekanikisht duke përdorur centrifugën në mënyrë që llumi i çujëzuar të ketë një përqendrim të mbetjes së thatë prej 20%. Llumi ruhet në shtretërit e tharjes së llumit për 12 muaj (ruajtje afatgjatë).

Bazuar në llogaritjet e procesit në raportin e dizajnit, prodhohet sasia e mëposhtme e llumit të dehidratuar:

Tabela 3. ITUN Gjakova - Kalkulimet e procesit për llumin e çujëzuar të deponuar në shtretërit e llumit

Parametri	Njësia	Faza A	Faza B
Prodhimi ditor i llumit të tepërt gjatë dimrit	Kg SS/ditë	1713	4.035

Prodhimi ditor i llumit të tepërt gjatë verës	Kg SS/ditë	1612	3.793
Sasia vjetore e mbetjes së thatë (DS) të llumit	Kg SS/vit	613.22 4	1.443.59 8
Sasia e mbetjes së thatë (DS) të llumit pas çujëzimit	Kg SS/m <sup>3</sup>	200	200
Sasia vjetore e llumit të çujëzuar	m <sup>3</sup> /vit	3066	7.218
Sasia mesatare mujore e llumit të çujëzuar	m <sup>3</sup> /muaj	256	601
DS e supozuar e llumit pas ruajtjes afatgjate	Kg SS/m <sup>3</sup>	350	350
Sasia vjetore e llumit pas ruajtjes afatgjate	m <sup>3</sup> /vit	1752,1	4124,6
Sasia mujore e llumit pas ruajtjes afatgjate	m <sup>3</sup> /muaj	146,0	343,7

### 3. Koncepti për largimin e llumit të ujërave të ndotura

Janë analizuar dhe diskutuar disa opsione sa i përket largimit të llumit të ITUN Gjakova ku janë mbajtur disa takimeve me personat përgjegjës të kompanive të përfshira për zgjidhjet e deponimit të llumit.

Koncepti i asgjësimit llumit të ujërave të ndotura i përmbahet hierarkisë së përcaktuar në Nenin 5 të Ligjit për Mbeturina - Ligji Nr.04/L-060: 1. Ripërdorimi i mbetjeve, 2. Djegia për gjenerimin e energjisë/nxehtësisë, 3. Deponimi në deponi.

#### 3.1. Partnerët e mundshëm lokalë

Për të vlerësuar mundësitë për asgjësimin llumit të ujërave të ndotura janë mbajtur takime dhe janë diskutuar mundësitë për bashkëpunim me këto kompani:

Tabela 4. Partnerët e mundshëm lokal si pika të daljes së llumit të ITUN Gjakova.

Kompania	Tema
KRU "Radoniqi-Dukagjini" Sh.A.	Përdorimi i llumit në bujqësi
Ngrohtorja e Qytetit të Gjakovës	Djegia e llumit në Impiantin e Ngrohtores së Qytetit
Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës – KMDK	Deponimi i llumit në deponinë e Prizrenit

### 3.2. Deponimi i llumit

Në tabelën e sipërme, pikat e daljes të mundshme të llumit ekzaminohen sipas praktikueshmërisë së tyre, kërkesave për cilësinë e llumit, kostove dhe faktorëve të mundshëm të rrezikut që mund të ndikojnë në besueshmërinë e tyre, nga të cilat nxirret fizibiliteti i përgjithshëm i secilës dalje.

Është e qartë se asnjë opsion i vetëm nuk mund të sigurojë një dalje të plotë, të besueshme ose të vazhdueshme për llumin dhe do të duhet të zhvillohen më shumë se një dalje për të siguruar fleksibilitet operacional.

Potenciali më i madh për deponimin e llumit do të jetë ripërdorimi në bujqësi në rajonin e Gjakovës. Sipas Kompanisë Rajonale të Ujitjes “Radoniqi-Dukagjini”, fermerët janë të gatshëm të përdorin llumin përderisa cilësia e llumit është e pranueshme për ta.

Potenciali për përdorimin e llumit në pylltari është i kufizuar. Për shkak të problemeve praktike të transportit të llumit (shumica e pyjeve janë në shpate të pjerrëta), ky opsion i asgjësimit ka një mundësi të ulët për t'u zbatuar.

Përdorimi i llumit në parqet komunale është i reduktuar për shkak të kërkesës shumë të vogël potenciale dhe mungesës së mundshme të pranimit për përdorimin e llumit në zonat që shfrytëzohen nga publiku.

Bonifikimi i tokës dhe restaurimi i deponive rajonale në të ardhmen ofron mundësi për të përdorur sasi të konsiderueshme të llumit. Për shkak të sasive të kufizuara të dheut në dispozicion me cilësi të dobët në vende të tilla, sasi të mëdha llumi mund të përdoret si aplikim i vetëm, por këto mundësi janë të rralla dhe në dispozicion vetëm për periudha të shkurtra kohore. Rrjedhimisht, llumi duhet të grumbullohet në mënyrë që të plotësohen kërkesa të tilla të larta në mënyrë periodike.

Djegia e llumit nga industritë me konsum të lartë energjie mund të jetë potencialisht e praktikueshme në fabrikën e çimentos në Sharrcem në Han të Elezit ose në dy termocentralet me qymyr (Kosova A dhe Kosova B) afër Prishtinës. Megjithatë, ky opsion nuk është tërheqës për KRUGJ për shkak të distancës dhe kostos së lartë të transportit; ose për industritë pasi kontributi i vogël i llumit në bilanci të tyre të përgjithshëm të energjisë nuk do të ishte kompensim i mjaftueshëm për kostot e përfshira në përshtatjen teknike dhe lejimin shtesë të objekteve të tyre. Djegia e përbashkët në fabrikat e tullave në Gjakovë dhe Prizren si dhe në termocentralin lokal në Gjakovë teknikisht nuk është e mundur pasi që ata përdorin Mazut për djegie.

Mundësia e kalimit të Mbeturave në Energji (MnE) nga tretja e llumit dhe prodhimi i biogazit është vetëm spekulative. Për momentin nuk ka asnjë objekt të tillë në Kosovë dhe për shkak të kostove të larta të investimit, të cilat nuk janë në dispozicion deri më tani, dhe faktit që sasia e prodhuar e llumit nuk është e mjaftueshme, një trajtim i tillë nuk do të jetë ekonomikisht i qëndrueshëm për KRUGJ.

Krahas ripërdorimit të llumit në bujqësi, një zgjidhje e dytë praktike për deponimin e llumit është deponimi në deponi bashkë me mbetjet e ngurta. Llumi pritet të deponohet në deponi nëse është mjaftueshëm i thatë për t'u përdorur si mbulesë për të zëvendësuar pjesërisht dheun që përdoret në mënyrë konvencionale, por që është e shtrenjtë dhe me mungesë. KRUGJ tashmë ka marrë



aprovimin nga Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës që llumi mund të deponohet në deponinë e Prizrenit (shih Shtojcën 4).

### **3.3. Përdorimi i llumit në bujqësi**

Siç u përmend më lart, potenciali më i madh për deponimin e llumit do të jetë ripërdorimi në bujqësi në rajonin e Gjakovës (shih Shtojcën 6). Sipas Kompanisë Rajonale të Ujitjes “Radoniqi-Dukagjini”, fermerët janë të gatshëm të përdorin llumin për aq kohë sa cilësia e llumit (përmbajtja e ujit, përqendrimi i metaleve të rënda) është e pranueshme për ta. Pajisjet teknike për shpërndarje janë në dispozicion dhe llumi mund të ruhet gjatë periudhave me kërkesë të ulët. Prandaj, teorikisht, bujqësia ka kapacitet të mjaftueshëm për të shfrytëzuar tërë sasinë e llumit të ITUN Gjakova, por në praktikë kjo mënyrë e deponimit ndoshta mund të ofrojë vetëm një zgjidhje të pjesshme.

Ekzistojnë kufizimet e mëposhtme:

- Sipas KRU “Radoniqi-Dukagjini” ka vetëm fermerë individual dhe jo shoqatë fermerësh/shoqata të shfrytëzuesve të ujit. KRU “Radoniqi-Dukagjini” ka 5,145 fermerë dhe 4,300 ha (shih Shtojcën
- Kërkesa sezonale e kufizuar në një periudhë të shkurtër të vitit. Kjo do të kërkonte që llumi të ruhet ose asgjësohet me mjete të tjera jashtë kësaj periudhe.
- Fermerët tradicionalë të cilët mund të mos jenë të gatshëm të përdorin llumin, veçanërisht për prodhime të përziera.
- Nuk ka informacion në dispozicion për përqendrimin e metaleve të rënda në tokën bujqësore në rajonin. Gjithsesi, ekzistojnë analiza të dheut në disa parcela si pjesë e projektit.

Pika e fundit mund të jetë problem serioz, pasi plehërimi gjatë dekadave të fundit mund të luajë një rol të rëndësishëm në futjen e metaleve të rënda në tokë. Në veçanti, plehurat minerale fosforike të prodhuara nga fosfatet sedimentare të shkëmbinjve shpesh përmbajnë nivele të larta të metaleve të rënda. Megjithatë, tokat bujqësore mund të marrin gjithashtu sasira të konsiderueshme të metaleve të rënda me pleh organik të fermës. Një burim tjetër janë emetimet atmosferike të metaleve të rënda (grimcat e hirit ose aerosolet) nga proceset industriale të hekurit dhe industrive të tjera, pasi Gjakova ishte një nga zonat më të mëdha industriale në ish-Jugosllavi. Prandaj rekomandohet të analizohet përqendrimi i metaleve të rënda në tokat bujqësore në të ardhmen e afërt!

Karakteristikat pozitive të këtij opsioni të asgjësimit janë:

- Ekziston një kërkesë e lartë latente për plehra organike pasi tokat janë të mangëta në lëndë organike dhe përdorimi i plehut organik të kafshëve.
- Fermerët paguajnë çmime të larta për plehurat kimike.

### **3.4. Deponimi i llumit në deponi**

Deponimi i llumit të ITUN Gjakova është i mundësuar edhe në deponinë e Prizrenit, e cila është rreth 30 km larg nga Gjakova. Megjithatë, deponimi i llumit në deponi njihet si i paqëndrueshëm për shkak të humbjes së vlerës që përmban llumi (lëndë ushqyese, lëndë organike) dhe duhet të

konsiderohet vetëm si opsioni i dytë në rast se ripërdorimi i llumit në bujqësi nuk është i mundur për shkak të mosgatishmërisë së fermerëve.

KRUGJ në një letër zyrtare drejtuar KMDK-së ka kërkuar përkohësisht depoimin e llumit të ITUN Gjakova në deponinë në Prizren (shih Shtojcën 2). KMDK ka konfirmuar me shkrim më 11 tetor 2022 se llumi do të pranohet për dy vjet në deponinë e operuar nga KMDK vetëm nën kushtet e mëposhtme (shih Shtojcën 4):

- Llumi është i tharë (përqendrimi i DS pas 12 muajsh i deponuar në shtretërit për tharje 20-35 %);
- Llumi nuk përmban asnjë element të rrezikshëm biologjiko-kimik për mjedisin;
- Nëse llumi paraqet ndonjë rrezik për mjedisin, ai nuk do të pranohet në deponi

Analiza e llumit të muajit Shtatori 2022 (shih Shtojcën 1) tregojnë që përqendrimi i metaleve të rënda është shumë i ulët dhe llumi ka thatësinë e kërkuar, prandaj nuk ka pengesa për deponim.

## 4. Vlerësimet ekonomike

### 4.1 Kostot e asgjësimit

Kostot operative për asgjësimin e mbetjeve të grilave, rërës, yndyrës dhe llumit të çujëzuar të ITUN Gjakova janë llogaritur si vijon:

*Tabela 5. Pasqyrë e kostove për asgjësimin mbetjeve nga grilat, rërës, yndyrës dhe llumit.*

Kostoja	Njësia	Çmimi
Kostoja e ngarkimit të llumit nga shtretërit e Tharjes me anë të eskavatorit.	EUR/t	1.50
Deponimi i llumit në deponinë e Prizrenit		
➤ Kostoja e transportit – nga KRM “Cabрати” Sh.A.	EUR/t	6.30
➤ Kostoja e deponimit të llumit nga KRM “Cabрати” Sh.A.	EUR/ m <sup>3</sup>	0.50
➤ Kostoja e deponimit të llumit nga KRM “Cabрати” Sh.A. për mbetjet e ngurta, rërën dhe yndyrën	EUR/t	12.20
Kostoja e mundshme e ngarkuar nga KRM “Cabрати” Sh.A. për deponimin e yndyrës	EUR/t	50.00
Kostoja për analizimin e llumit, çmimi i parametrave të përcaktuara sipas UA 29/2014 Aneksi 4	EUR /mostër	225.87

Kostoja e analizave të dheut, çmimi i parametrave të përcaktuara sipas UA 29/2014 Aneksi 5 (i vlerësuar pa u mostruar).	EUR /mostër	40.00
---	-------------	-------

Bazat për paraqitjen e kostos së mësipërme janë marrëveshjet ose kontratat e mëposhtme:

- Kontrata me KRM "Cabрати" për transportin dhe deponimin e llumit në deponinë e Prizrenit (Landovicë). (shih Shtojcën 5)
- Kontrata ekzistuese e deponimit me KRM "Cabрати" për transport dhe asgjësimi i mbetjeve nga grilat dhe rërës në deponinë e Prizrenit (kontrata e përgjithshme për largimin e mbeturinave).
- Lista e çmimeve nga laboratorit Horn & Co Analytics Gn. (shih Shtojcën 1)

Tabela 6. Vlerësimi i kostos së përdorimit të llumit për bujqësi dhe deponimi në deponi.

<u>Deponimi i llumit</u>			
		<b>Ripëdori mi në bujqësi</b>	<b>Deponimi në deponi</b>
Pesha totale e llumit pas qëndrimit afatgjatë (DS 35%)	t/muaj	146.01	146.01
Kostoja totale e ngarkesës / muaj	EUR/muaj	219.01	219.01
Kostoja totale e transportit	EUR/muaj	0.00*	919.86
Kostoja totale e hyrjes në deponi	EUR/muaj	0.00	73.00
Kostoja e analizave të tokës (dheut)	EUR/muaj	0.00 **	0.00
Kostoja e analizave të llumit	EUR/vit	451.74 <sup>2</sup>	451.74 <sup>2</sup>
<b>Kostoja totale e deponimit të llumit, pa analiza të llumit</b>	<b>EUR/muaj</b>	<b>219.01</b>	<b>1,211.87</b>
<b>Kostoja totale e deponimit të llumit</b>	<b>EUR/vit</b>	<b>3,079.86</b>	<b>14,994.18</b>

\* Nuk parashihet kosto për transportin e llumit gjatë deponimit për bujqësi pasi supozohet se fermerët do të bëjnë mbledhjen e llumit në ITUN me automjetet e tyre vetanake (traktorë dhe rimorkio) si dhe do e bëjnë vetë shpërndarjen.

\*\* Nuk parashihet kosto për analizat e tokës, pasi që ato do të paguhen nga fermerët.

<sup>2</sup> Brenda 1 viti 2 pjesë të analizave.

Bazuar në llogaritjet, kosto për deponimin e llumit në deponi janë pothuajse 5 herë më të larta se ripërdorimi i llumit në bujqësi për shkak të kostove të larta të transportit në deponinë në Prizren.

Përveç kësaj ripërdorimi i llumit në bujqësi do të riciklojë lëndët ushqyese dhe lëndën organike, do të rrisë prodhimin e të korrave dhe do të reduktojë përdorimin e plehrave kimike duke përmirësuar vetitë fizike të tokës; shitja e llumit fermerëve gjeneron të ardhura për KRU Gjakovën.

#### 4.2 Kostot e investimit

Janë vlerësuar në përgjithësi kostot e investimit për deponimin e mbetjeve nga grilat, rërës, yndyrës dhe llumit të çujëzuar të ITUN Gjakova. Meqenëse investimet ndryshojnë në varësi të opsionit të asgjësimit të llumit, janë analizuar dy opsionet (Opsioni 1: Ripërdorimi në Bujqësi dhe Opsioni 2: Deponimi i deponi). (shih tabelen 8)

Tabela 7. Kostot e investimit për mbetjet nga grilat, rërën, yndyrën dhe llumin e ITUN Gjakova.

Lënda	Njësia	Opsioni 1: Ripërdorimi në bujqësi			Opsioni 2: Deponimi në deponi		
		Sasia	Çmimi i njësisë	Çmimi total	Sasia	Çmimi i njësisë	Çmimi total
<b>Deponimi i mbetjeve të grilave</b>							
Kontenierë	copë	2	600 €	1,200 €	2	600 €	1,200 €
Mjeti ngarkues dhe transportues	copë	1	40,000 €	40,000 €			
<b>Deponimi i rërës</b>							
Kontenierë	copë	2	600 €	1,200 €	2	600 €	1,200 €
<b>Deponimi i yndyrës</b>							
Kontenierë	copë	1	600 €	600 €	1	600 €	600 €
<b>Deponimi i llumit</b>							
Mjetet ngarkuese dhe transportuese	copë	2	60,100 €	60,100 €	5	166,500 €	172,000 €
<b>TOTAL</b>				<b>104,000 €</b>			<b>175,000 €</b>

Shënim: Çmimet Neto në EURO;

## 5. Funksionimi praktik i asgjësimit të llumit të ITUN Gjakova

Është bërë përmbledhja e disa nga çështjeve kryesore që lidhen me funksionimin praktik të ripërdorimit të llumit të ujërave të ndotura në bujqësi (përfshirë marketingun e llumit) dhe deponimi në deponin. Kontraktori në bashkëpunim me Konsulentin për Masat Shoqëruese ka zhvilluar udhëzime mbi procedurat operative, veçanërisht në lidhje me vlerësimin e tokës, monitorimin dhe ruajtjen e të dhënave. Tabela 8 tregon një plan veprimi për aktivitetet e nevojshme për organizimin e deponimit të llumit në bujqësi.

Tabela 8. Plani i veprimit për ripërdorimin e llumit të ITUN në bujqësi.

Nr.	Aktivitetet
1.	Të paraqitet një propozim për vlerat e limituara të nutrientëve në bashkëpunim me grupin e ekspertëve.
2.	Organizimi i "Ditëve të hapura" në ITUN Gjakova
3.	Kontaktimi kompaninë e ujitjes për të identifikuar fermerët e interesuar për përdorimin e llumit
4.	Krijimi i testeve demonstruese në terren dhe monitorimi shkencor i aplikimit të llumit në bashkëpunim me IBK
5.	Përgatitja e Udhëzuesit të Fermerëve për Përdorimin Bujqësor të llumit
6.	Komunikimi i rezultateve të testeve përmes artikujve të mediave të përgjithshme, raporteve shkencore dhe punimeve për një audiencë më të gjerë publike dhe qeveritare
7.	Përgatitja e bazës së të dhënave për menaxhimin e llumit
8.	Analiza e llumit çdo 6 muaj
9.	Monitorimi i shpërndarjes së llumit nga fermerët dhe mirëmbajtësit e hapsirave gjelbëruese

### 5.1 Përgjegjësitë dhe aktivitetet e KRUGJ gjatë aplikimit të llumit

Në miratimin e qasjes për menaxhimin e llumit për përdorim dhe asgjësim të mëvonshëm, në vijim janë përmbledhur përgjegjësitë dhe aktivitetet kryesore të KRU Gjakova (shih gjithashtu Kapitullin 2.1.3 dhe 2.1.4).

Prodhuesi i llumit KRU Gjakova do të sigurojë që:

- Llumi prodhohet nga ITUN Gjakova sipas cilësisë së specifikuar nga dizajni i ITUN dhe llumi thahet nga dielli për të arritur përmbajtjen e synuar të llumit të ngurtë të thatë, në përputhje me kërkesat ligjore të Kosovës për ripërdorimin e llumit të ujërave të ndotura dhe duke përmbushur kërkesat e konsumatorëve.

- Llumi analizohet në intervale jo më shumë se 6 muaj për parametrat e specifikuar me Udhëzimin Administrativ UA 29/2014 për ripërdorimin e llumit, dhe ky informacion u jepet fermerëve dhe operatorit të deponisë KMDK
  - Të krijohet dhe mirëmbahet një bazë e të dhënave për menaxhimin e llumit për të regjistruar informacionet e specifikuara me Udhëzimin Administrativ UA 29/2014.
  - Mbahen shënime për sasi të dhe cilësinë e llumit të transferuar tek fermerët dhe deponia nga KMDK.
  - Raportet periodike për aktivitetet e menaxhimit të llumit përgatiten për t'iu dorëzuar komunave dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
  - Fermerët/përdoruesit e llumit të jenë të informuar/ familjarizuar me përdorimin e llumit në tokë dhe respektojnë rregullat e përdorimit të llumit në lidhje me cilësinë e llumit, cilësinë e tokës dhe shkallën e aplikimit të llumit në kulturat e lejuara.
  - Është zhvilluar dhe zbatuar një strategji e marketingut të llumit.
  - Sasia e llumit të deponuar në deponi është minimizuar aq sa është praktikisht e mundur.
  - Tarifat e rëna dakord i paguhen KRM "Cabrat" sipas sasisë së llumit.
- Tabela e mëposhtme tregon hapat e nevojshëm të punës që kërkohen për zbatimin sa më të shpejtë të përdorimit bujqësor të llumit të ujërave të zeza.

## 5.2. Kërkesat për ruajtjen e llumit

Aktivitetet bujqësore janë shumë sezonale. Për shkak të kufizimeve të Udhëzimit Administrativ Nr. 29/ 2014 për Menaxhimin e Llumit për aplikimin e llumit në bujqësi gjatë sezonit të rritjes dhe korrjes; periudha kryesore e aplikimit të llumit do të jetë nga mesi i vjeshtës deri në fillim të pranverës dhe kërkesa e fermerëve për llum do të jetë më e madhe gjatë kësaj periudhe. Por gjithashtu duhet të merret parasysh temperatura. Përhapja e llumit në tokë të ngrirë dhe të mbuluar me borë është kritike. Ndryshimet e motit rrisin mundësinë e lëvizjes së llumit me rrjedhjen sipërfaqësore. Rrjedhja e ujit mund të çojë në ndotje të burimeve ujore duke përfshirë përrrenjtë, rrugët ujore dhe pusët. Përveç ndikimit në cilësinë e ujit, edhe lëndët ushqyese humbasin dhe nuk janë në dispozicion për të korrat e vitit të ardhshëm. Prandaj koha për shpërndarjen e llumit nga Dhjetori në Shkurt është e kufizuar pasi toka mund të ngrihet.

Rrjedhimisht, kërkohet kapaciteti i mjaftueshëm deponimi për të kapërcyer periudhat e kur kërkesa është e ulët, duke supozuar se i gjithë llumi do të përdoret në tokë/bujqësi. Sipas projektimit të shtretërve të tharjes së llumit ITUN Gjakova ka një kapacitet deponues për 12 muaj.

## 5.3. Kërkesat për transportin e llumit

Meqenëse fermat në rajonin e Gjakovës janë të vogla dhe qasja është shpesh e vështirë, gjë që do të kufizojë përdorimin e kamionëve të mëdhenj, fermerët duhet të inkurajohen që të mbledhin llum me automjetet e tyre vetanake. Sipas të dhënave të Regjistrimit të Bujqësisë në Kosovë për rajonin e Gjakovës (2014) rreth 50 % e fermerëve janë të pajisur me traktorë dhe rimorkio për transport. Disa prej tyre kanë edhe shpërndarës të plehut që mund të përdoret për përhapjen e llumit në tokat bujqësore.

Në rast nevojë për të transportuar llumin e tharë në deponinë në Prizren, KRM "Cabрати" do të sigurojë transportin sipas kontratës së nënshkruar (shih Shtojcën 5).

#### **5.4. Marketingu i llumit**

Gjatë fillimeve të ripërdorimit të llumit në bujqësi, sigurisht do të ketë shqetësime të publikut dhe fermerëve në lidhje me sigurinë për shkak të kufizimeve normale sociale. Rrjedhimisht, zhvillimi dhe themelimi i një programi për ripërdorimin e llumit ku nuk ka përvojë të mëparshme të përdorimit të llumit të ITUN në bujqësi si dhe në rajonin e Gjakovës, kërkohet një qasje marketingu për të tërhequr, siguruar dhe kënaqur fermerët. Fushatat e trajnimit dhe ndërgjegjësimit të publikut janë të rëndësishme për të siguruar që të gjithë palët e interesuara të jenë të informuara siç duhet për çështjet e llumit dhe për të zgjidhur çdo keqkuptim dhe paragjykim të llumit.

##### **5.4.1. Strategjia e marketingut**

Duhet pasur parasysh se pranimi i llumit nga fermerët është vullnetar dhe si pasojë siguria e ripërdorimit të llumit në bujqësi është e cenueshme nëse përdoruesi humb besimin në "produkt" ose merr shërbim të dobët. Prandaj, për një zbatim të suksesshëm të synuar për deponimin e llumit, KRU Gjakova do të mbajë një qasje të bazuar në sigurimin e cilësisë dhe kujdesin ndaj klientit.

Shqetësimet kryesore që duhet të adresohen në një fushatë marketingu/ndërgjegjësimi publik janë:

- Aspektet shëndetësore, duke përfshirë punëtorët që trajtojnë llumin dhe konsumatorët e të korrave;
- Vlera agronomike, veçanërisht besueshmëria e furnizimit me lëndë ushqyese dhe efektet e mundshme të dëmshme në rritjen ose cilësinë e të korrave;
- Ndikimet e mundshme mjedisore, veçanërisht në burimet ujore, cilësinë e tokës dhe aromën dhe shqetësimin nga insektet (mizat).

Më poshtë janë komponentët thelbësorë në procesin e marketingut që duhet të kryhen për t'u dhënë besim të gjithë fermerëve në produktin dhe shërbimin dhe për të ndihmuar në sigurimin e përdorimit të vazhdueshëm të llumit prej tyre:

- Ditët e hapura në ITUN Gjakova për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për përmirësimet e gjendjes së ujërave të ndotura dhe implementimin e ITUN-eve dhe menaxhimin e llumit;
- Zhvillimi i një baze të të dhënave për menaxhimin e llumit të fermerëve si bazë për deponimin e llumit dhe regjistrimin e aktiviteteve të përdorimit të llumit të ITUN;
- Provat demonstruese në terren për t'u treguar fermerëve se llumi është i dobishëm dhe i sigurt;
- Cilësi e lartë e shërbimit në prodhimin dhe furnizimin e llumit (programet e kontrollit dhe monitorimit, ofrimi i këshillave).

#### **5.4.2 Shitja e llumit**

Menaxhimi i llumit është i kushtueshëm dhe mund të përbëjë deri në 50% të kostove totale të menaxhimit të ujërave të ndotura, kështu që mbulimi i të paktën një pjese të kostove të mbuluara nga shitja e llumit do të ishte më se e dobishme.

Fermerët do ta shohin llumin si çdo produkt tjetër që e përdorin për prodhimtari fitimprurëse të mbjellave, i cili ndikohet nga kostot (blerja, transporti, aplikimi), ndikimet (aroma, ndotja e tokës, shitja e të korrave, vlera e tokës, pranueshmëria sociale) dhe përfitimet (rritja e rendimentit, reduktimin e kostove të tjera).

Si me çdo produkt, çmimi ndikon në kërkesë dhe rrjedhimisht KRUGJ do të jetë realist në lidhje me çmimin që përdoruesit janë të gatshëm të paguajnë. Prandaj, marketingu i mirë dhe ndoshta provat demonstruese janë të rëndësishme për të demonstruar vlerën e llumit dhe për të rritur vlerën e tij të tregut. KRUGJ ka gjithashtu opsionin e deponimit të llumit në deponi, kështu që shitja e llumit me më pak se kostoja e prodhimit apo edhe ofrimi falas mund të jetë ende ekonomikisht i dobishëm pasi do të rrisë disa të ardhura ose kursen kostot në vend që të paguajë për deponimin e deponisë.



## Përmbledhja

Në parim ekzistojnë dy opsione për asgjësimin e llumit të ujërave të ndotura nga ITUN Gjakova:

a) Deponimi i llumit në deponinë e Prizrenit (Landovicë) është një nga opsionet në dispozicion. KRUGJ ka marrë tashmë konfirmimin me shkrim nga operatori i deponisë në Prizren (KMDK) se llumi do të pranohet. Ky opsion nuk mbështetet për arsye të kostos dhe jo-qëndrueshmërisë, veçanërisht për humbjen e vlerës së llumit (nutrientët, lëndët organike) dhe kosto të larta të transportit. Megjithatë, do të konsiderohet si një zgjidhje e përkohshme gjatë krijimit të opsionit të dytë të asgjësimit, d.m.th. shfrytëzimit në bujqësi, ose në rastet kur është i pamundur që llumi nga ITUN të përdoret në bujqësi (p.sh. nëse do të tejkalohen vlerat e përqendrimit të metaleve të rënda në llum) ose llumi nuk do të pranohet nga fermerët vendas.

b) Ripërdorimi i llumit në bujqësi për momentin është opsioni i preferuar i asgjësimit të llumit. Kjo zgjidhje ndjek hierarkinë e Ligjit për Mbeturina (LM) - Ligji Nr. 04/L-060, ku thuhet se mbeturinat (llumrat janë mbeturina sipas LM) duhet të ripërdoren ose riciklohen para se të deponohen në deponi. Ripërdorimi i llumit në bujqësi siguron që lëndët ushqyese (nutrientët) dhe lëndët organike të riciklohen, do të rrisë prodhimin e të korrave, zvogëlon përdorimin e plehrave kimike duke përmirësuar vetitë fizike të tokës në lidhje me kultivueshmërinë e saj, ruajtjen e lëndëve ushqyese dhe kapacitetin e mbajtjes së lagështisë. Kjo zgjidhje do të marrë kohë për t'u ndërtuar në një hark kohor prej 1 deri në 2 vjet, pasi duhet të bëhen analizat e llumit disa herë dhe fermerët duhet të sensibilizohen. Megjithatë, në afat të gjatë kjo zgjidhje është më e lirë dhe ekologjikisht e favorshme duke u bazuar në kushtet lokale për momentin.

# SHTOJCA

## Shtojca 1. Rezultatet e analizave të llumit të ITUN Gjakova

**Sample Identification** S20220003 (Sludge Samples S1)

**Origin** WWTP Gjakova

**Place of Sampling** WWTP Gjakova

**Remarks**

### Results of Analysis

Parameter	Result	Units	SOP		Place
sampling protocol	unavailable				Wen
sample homogenisation	to 200 g		DepV Anhang 4 Nr. 3.1.1	4*	Wen
sample preparation	yes		DIN 19747	1*	Wen
Moisture content (105 °C)	8,68	%	DIN EN 14346	1*	Wen
Dry residue (105 °C)	91,3	%	DIN EN 14346	1*	Wen
Water soluble amount	0,873	%	DIN 38409-1	1*	Wen
Water soluble amount	873	mg/L	DIN EN 15216	1*	Wen
Total organic carbon (dry substance)	1,29	%	DIN EN 15936	1*	Wen
Hydrocarbon oil index C10-C22 (dry substance)	<100	mg/kg	DIN EN 14039	1*	Wen
Hydrocarbon oil index C10-C40 (dry substance)	<100	mg/kg	DIN EN 14039	1*	Wen
Sum benzene and derivates (dry substance)	<1	mg/kg	DIN EN ISO 22155	1*	Wen
Sum benzene and derivates (dry substance)	<1	mg/kg	DIN EN ISO 22155	1*	Wen
Naphthalene	<0,01	mg/kg	DIN ISO 18287	1*	Wen
Benzo(a)pyrene	<0,01	mg/kg	DIN ISO 18287	1*	Wen
Sum of 16 EPA PAH's (dry substance)	<1	mg/kg	DIN ISO 18287	1*	Wen
Sum of 6 PCB's (dry substance)	<0,01	mg/kg	DIN 38414-20	1*	Wen
Sum of 7 PCB's (dry substance)	<0,01	mg/kg	DIN EN 15308	1*	Wen
HCl/HNO3-acid digestion (dry substance)	ja		DIN EN 13346	1*	Wen
Arsenic (dry substance)	1,29	mg/kg	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Lead (dry substance)	29,9	mg/kg	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Cadmium (dry substance)	1,07	mg/kg	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Chromium (dry substance)	69,8	mg/kg	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Copper (dry substance)	155	mg/kg	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Nickel (dry substance)	89,8	mg/kg	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Mercury (dry substance)	2,04	mg/kg	DIN EN ISO 12846	2*	Wen

page 1 of 3



**Horn & Co. Analytics Gm**

Further approvals and notifications see: [www.horn-co.de](http://www.horn-co.de)

A part of Horn & Co. I

**Contact**

Herr Halili

Frau Hoti

**Sample Identification** S20220003 (Sludge Samples S1)**Origin** WWTP Gjakova**Place of Sampling** WWTP Gjakova

Parameter	Result	Units	SOP		Place
Zinc (dry substance)	666	mg/kg	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Phosphorus (dry substance)	13000	mg/kg	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Nitrogen, total (dry sample)	4,36	%	DIN EN ISO 15351	2*	Wen
Leaching by water	ja		DIN EN 12457-4	1*	Wen
pH-value (Leaching)	7,60		DIN EN ISO 10523	1*	Wen
Electrical conductivity (25°C) (Leaching)	1750	µS/cm	DIN EN 27888	1*	Wen
Phenole index (Leaching)	0,198	mg/L	DIN EN ISO 14402	1*	Wen
Dissolved organic carbon (leaching)	2,44	mg/L	DIN EN 1484	1*	Wen
Chloride-IC (Leaching)	8,09	mg/L	DIN EN ISO 10304-1	1*	Wen
Fluoride-IC (Leaching)	0,82	mg/L	DIN EN ISO 10304-1	1*	Wen
Sulfate-IC (Leaching)	89,4	mg/L	DIN EN ISO 10304-1	1*	Wen
Antimony (Leaching)	<0,005	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Arsenic (Leaching)	<0,01	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Barium (Leaching)	0,031	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Lead (Leaching)	<0,01	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Cadmium (Leaching)	<0,001	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Chromium, total (Leaching)	0,0067	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Copper (Leaching)	0,074	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Molybdenum (Leaching)	0,054	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Nickel (Leaching)	0,13	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Mercury AAS (Leaching)	<0,0001	mg/L	DIN EN ISO 12846	1*	Wen
Selenium (Leaching)	<0,01	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen
Zinc (Leaching)	0,25	mg/L	DIN EN ISO 11885	1*	Wen

1\* Accredited test method: 1\*: Yes; 2\*: Yes, with modifications; 3\*: Yes, Subcontracted // 4\*: No 5\*: External laboratory

Place of determination: Wen: Laboratory Wenden, Wtz: Laboratory Wetzlar, Sie: Laboratory Siegen, Wit: Laboratory Witten

The test results only refer to the samples delivered to or taken by Horn &amp; Co. Analytics GmbH. Incorrectly provided samples can affect the test results. The results given include measurement uncertainties, which can be requested if required.

The test report may only be duplicated in extracts with the consent of Horn &amp; Co. Analytics GmbH.

page 2 of 3

**Horn & Co. Analytics Gm**

A part of Horn &amp; Co. I

Further approvals and notifications see: www.horn-co.de

**Contact**

Herr Halili

Frau Hoti

**Sample Identification** S20220003 (Sludge Samples S1)**Origin** WWTP Gjakova**Place of Sampling** WWTP Gjakova**Summary of applied standards**

DIN 19747: 2009-07

DIN 38409-1: 1987-01

DIN 38414-20: 1996-01

DIN EN 12457-4: 2003-01

DIN EN 13346: 2001-04

DIN EN 14039: 2005-01

DIN EN 14346: 2007-03

DIN EN 1484: 2019-04

DIN EN 15216: 2008-01

DIN EN 15308: 2016-12

DIN EN 15936: 2012-11

DIN EN 27888: 1993-11

DIN EN ISO 10304-1: 2009-07

DIN EN ISO 10523: 2012-04

DIN EN ISO 11885: 2009-09

DIN EN ISO 12846: 2012-08

DIN EN ISO 14402: 1999-12

DIN EN ISO 15351: 2010-08

DIN EN ISO 22155: 2013-05

DIN EN ISO 22155: 2016-07

DIN ISO 18287: 2006-05

DepV Anhang 4 Nr. 3.1.1: 2009-04

Horn &amp; Co. Analytics GmbH, Wenden 16.09.2022

ppa. Dr. Mechthild Grebe  
Laborleitung

## Shtojca 2. Kërkesë MMPH për deponim të llumit në deponinë e Prizrenit



**Kompania Rajonale e Ujësjellësit**  
Regional Water Supply Company  
Regionalna vodovodna kompanija

Datë/a	08.09.2022
Për/Za/To	Ibrahim Bala Departamenti për Mbrojte të Mjedisit - MMPH
Nga/Od/From	Visar Hasi – U. D. Kryeshef Ekzekutiv, KRU “Gjakova” Sh.A
Tema/Subjekat/Subject	<b>Arsyeshmëri - Deponimi i llumit në deponin e Prizrenit</b>

### I nderuar Z. Bala,

Sipas Koncept-dokumentit për Menaxhimin e Llumit (kërkesa nr. 4567/17-664, të datës 15.09.2017), shfrytëzimi i llumit në bujqësi ka qenë opsioni më i preferuar në krahasim me opsionin e dytë; deponimi i llumit në deponi. Megjithatë, për shkak të arsyeve të paraqitura më poshtë, aktualisht, e vetmja zgjidhje praktike dhe e zbatueshme mbetet deponimi në **deponi**, i llumit të gjeneruar nga ITUN-i në Gjakovë:

- **Fushatat ndërgjegjësuese** që priten të organizohen me fermerë, zakonisht duhen kohë për realizimin e suksesshëm të tyre. Një gjë e tillë nuk është bërë deri tani meqë Impianti në fjalë nuk kishte filluar me gjenerimin e llumit. Normalisht, fermerët do të preferonin të shihnin përbërjen dhe karakteristikat e llumit, për t’u bindur në lidhje me përdorimin e tij në bujqësi. Një gjë e tillë është e mundur vetëm pasi që llumi të jetë gjeneruar, është stabilizuar dhe është tharë sa duhet. Pra, fushata ndërgjegjësuese është një aktivitet afatgjatë, i cili kërkon kohë për t’i bindur fermerët në pranimin e përdorimit të llumit për qëllime bujqësore.
- **Nevoja për llum është e domosdoshme vetëm gjatë periudhave të caktuara sezonale**  
Gjenerimi i llumit nga impianti në fjalë bëhet vazhdimisht gjatë tërë vitit. Ndërsa procesi trajtimit dhe stabilizimit shtesë, përfshi tharjen në shtretërit për tharjen e llumit kërkon kohë nga 6 deri 12 muaj, varësisht nga kushtet klimatike (verës thahet më shpejtë, ndërsa dimrit më ngadalë). Llumi i tharë dhe i stabilizuar mund të përdoret varësisht edhe nga kulturat e caktuara të mbjella gjatë vitit. Pra, për të organizuar shfrytëzimin e llumit për qëllime bujqësore, duhet kohë e mjaftueshme edhe nëse procesi i përzgjedhjes së fermerëve ka përfunduar. Si përfundim, përdërisa të bëhet identifikimi i fermerëve potencial të interesuar për llum, ekziston nevoja që deri atëherë llumi i gjeneruar të deponohet në deponi.

- **Ngastrat janë të vogla**

Meqë një numër i madh i ngastrave bujqësore janë të vogla, atëherë marketingu, transportimi, monitorimi i dheut, aspekti logjistik dhe administrativ del të jetë një proces kompleks dhe i kushtueshëm. Sipas të dhënave të ndërmarrjes për ujitje "Radoniqi-Dukagjini" nuk ka ndonjë organizim të fermerëve, p.sh: (5,145 fermerë me 4,300 ha), por ka vetëm fermerë individual. Një gjë e tillë mund të kufizoj interesimin potencial të tyre për shfrytëzimin e llumit në bujqësi.

- **Kufizimet kohore.**

Sipas projektit të shtretërve për tharje të llumit në ITUN-in e Gjakovës, kapaciteti për ruajtjen e llumit është 12 muaj. Meqë ITUN, është në funksion që nga muaji mars 2022, atëherë pritet që kapacitetet për ruajtjen e llumit të shterojnë në shkurt të 2023. Pas kësaj periudhe, i tërë procesi i trajtimit të ujërave të ndotura dhe trajtimi i llumit, do të vihej në rrezik, nëse nuk bëhet zgjidhje për largimin e llumit.

Përpos deponimit të llumit në deponi, KRU Gjakova, do të hulumtoj edhe opsionin e dytë, pra shfrytëzimin e llumit për qëllime bujqësore. Mostrat dhe analizat e llumit do të bëhet intensivisht gjatë periudhave të ndryshme kohore, për të dëshmuar cilësinë e llumit. Shfrytëzimi i llumit në bujqësi do të bëhet atëherë kur të jenë identifikuar fermerë të mjaftueshëm të interesuar për këtë qëllim.

Siç e kemi potencuar në letrën tonë nr. 4567/17-664/, të datës 15.09.2017, KRUGJ përmes një shkrese zyrtare i ka kërkuar KMDK-së, leje për deponimin e llumit në deponin e Prizrenit, në rast se shfrytëzimi i llumit për nevoja bujqësore dështon për çfarëdo arsye (shih shtojcën 1).

KMDK, përmes një letre të datës 14 nëntor 2016, kishte konfirmuar që llumi do të pranohej në deponinë operuar nga ata, duke ofruar dhe tarifat për një shërbim të tillë.

Në bazë të karakteristikave të llumit të gjeneruar, nuk ka ndonjë pengesë për deponimin e llumit në deponi.

Prandaj, me mirësi ju kërkohet që të miratoni kërkesën tonë për deponimin e llumit të ITUN-it të Gjakovës në deponin e Prizrenit, me qëllim që të vazhdojmë diskutimet me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës.

Në rast të paqartësive, mos hezitoni të na kontaktoni

Me shumë respekt,

Visar Hasi

Shtojcat:

- Shtojca 1- Kërkesa me shkrim e KRUGJ-së për KMDK-në
- Shtojca 2- Miratimi i kërkesës nga KMDK-ja për deponim të mbeturinave dhe llumit.

### **Shtojca 3. Aprovimi nga MMHP për deponimin e llumit të ITUN Gjakova në deponinë e Prizrenit**

**Subject:**RE: Deponimi i llumit të ITUN Gjakova në deponinë e Prizrenit

**Date:**2022-09-13 09:35

**From:**Ibrahim Balaj <[Ibrahim.Balaj@rks-gov.net](mailto:Ibrahim.Balaj@rks-gov.net)>

**To:**Hamdi Berisha <[hamdi.berisha@sawa-int.com](mailto:hamdi.berisha@sawa-int.com)>

**Cc:**Servet Spahiu <[Servet.Spahiu@rks-gov.net](mailto:Servet.Spahiu@rks-gov.net)>, Ismail Hetemaj <[Ismail.Hetemaj@rks-gov.net](mailto:Ismail.Hetemaj@rks-gov.net)>, LenditaSopa <[Lendita.Sopa@rks-gov.net](mailto:Lendita.Sopa@rks-gov.net)>

Të nderuar,

Pas shqyrtimit të kërkesës të KRU "Gjakova" SH.A. për lejimin e deponimit të Lymit (Llumit) tëtharë nga trajtimi I ujërave të ndotura në deponin regjionale në Landovicë ju njoftojm si në vijim:

- Në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr. 29/2014 Për Menaxhimin e Lymit ngaTrajtimi i Ujërave të Ndotura, me specifik neni 5, 8 dhe 9, pa përjashtuar nenet tjera të këtijUdhëzimi Administrativ, Lymi (Llumi) i trajtuar rekomandohet të përdoret ne bujqësi.
- Në rastet kur lymi (Llumi) i trajtuar për arsye të caktuara, të përshkruar në kërkesën e datës08.09.2022 të drejtuar MMPHI (ngastrat e vogla, kufizimet kohore për ruajtjen e lymit etj) nuk gjenë zbatim në bujqësi apo nuk përdoret në bujqësi, sipas dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 Për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave, neni 9, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 dhe 2.3, lymi (Llumi) i trajtuar sipas dizpozitave të Udhëzimit Administrativ nr. 29/2014 Për Menaxhimin e Lymit nga

Trajtimi i Ujërave të Ndotura, si inert (dheu) mund të shfrytëzohet për mbulesë të shtresave të deponisë, duke u bazuar në nevojat e deponisë për mbulesë të shtresave të mbeturinave në deponi në sasi të kontrolluar sipas planit për menaxhimin e deponisë.

- Bazuar në kërkesën e KRU "Gjakova" SH.A. në Gjakovë , MMPHI, përkatësisht Divizioni për mbeturina dhe kimikate në rastin konkret, vlerëson se Lymi I trajtuar mund të deponohet nëdeponi për kohësisht në afat për dy vite nga KMDK, deri sa KRU "Gjakova" SH.A. në Gjakovëti plotësoj kushtet në mënyrë që lymi (Llumi) i tajtuar të përdoret në bujqësi.

Me respekt,

Ibrahim Balaj



## **Shtojca 4. Leja për deponim të llumit dhe përcaktimi i tarifës nga Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës**

*Subject:Re: Fwd: RE: Deponimi i llumit të ITUN Gjakova në deponinë e Prizrenit*

**Date:**2022-10-11 15:53

*From:*Abdullah Haxhiu <[abdullah.haxhiu@kmdk-ks.org](mailto:abdullah.haxhiu@kmdk-ks.org)>

**To:**"Fjolla Lasku" <[fjolla.lasku@kru-gjakova.com](mailto:fjolla.lasku@kru-gjakova.com)>

E nderuara Z. Fjolla Lasku

Bazuar në kërkesën tuaj drejtuar KMDK SH.A dhe MMPHI dhe përgjigjjen e dhënë nga Z. IbrahimBalaj, KMDK SH.A do e pranoj Llumin nëç aft prej dy viteve, pas kësaj kohe , Ju llumin duhet të përgatitni (trajtoni) për përdorim në bujqësi.


Sa i përket tarifës(çmimorës) për pranim të llumit në deponi, ju duhet të kërkonit nga Ministria e Ekonomisë për të ju informuar se cila është tarifa për pranim të llumit, në të kundërtën KMDK do aplikoj tarifën, që e aplikon për pranim të materialit inert (dheut) sipas rregullores së brendshme momentalisht është 0.50Euro për metër/kub.

P.S. KMDK do e pranoj Llumin i cili do i përmbush kriteret që ju kemi dërguar në shkresat e më hershme dhe me kushtin që, për aq sasi të Llumit që sjellni në deponi duhet të sjellin po aq sasi tëdheut në mënyrë që të bëjmë përzierjen e këtyre materialeve , më qëllim të eliminimit të kundërmimit dhe problemeve eventuale që mund të sjell deponimi i llumit.

Me respekt,

## Shtojca 5. Kontrata me KRU "Çabрати" për transportimin e llumit në deponinë e Prizrenit.

30. 11. 2022  
2946

**KOMPANIJA REGIONALE E MBËTUNNAVE  
REGIONAL WASTE COMPANY  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTRADA**  
**K.R.M. "ÇABRATI"**  
Të: +383(0)46/321 733  
+383(0)46/324 834  
+383(0)46/19 35 35  
www.cabrati.com  
e-mail: info@cabrati.com  
Gjithë - Gjithë

### KONTRATË PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE

E lidhur me datë 30 nëntor 2022, ndërmjet palëve:

1. **K.R.M. "ÇABRATI" SH.A.** (person juridik) me seli në Gjakovë rr. "Mazllum Lakuci", me numër Unik Identifikues; (811299165), Të cilën e përfaqëson z. Behar Ferizi, Kryeshef Ekzekutiv; në tekstin e mëtejshëm: *Kryerësi i Shërbimeve*.
2. **KRU "GJAKOVA" Sh.A.** (person juridik), me seli në Gjakovë rr. "UÇK" 7 Gjakove, të cilën e përfaqëson Kryeshefi Ekzekutive z. Hasan Krasniqi, në tekstin vijues: *Porositësi i Shërbimeve*

Palët me cilësitë që u njih ligji në Republikën e Kosovës dhe vullnet të lirë, bien dakord të hartojnë, nënshkruajnë dhe respektojnë këtë marrëveshje si më poshtë vijon:

#### Neni 1 (BAZA LIGJORE E MARRËVESHJES)

Ligji Nr. 04/L-077, për Marrëdhëniet e Detyrimeve;  
Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092;

Duke marrë parasysh konsideratat dhe kushtet e premtimet reciproke të parashtruara këtu, personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj Kontrate për kryerjen e shërbimeve si, "Kryerësi i Shërbimeve" dhe personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj Kontrate si Porositësi i Shërbimeve bien dakord si vijon:

#### KONTRATË PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE

- Kjo Kontratë do të përdoret për të siguruar dhe rregulluar marrëdhëniet ndërmjet palëve për realizimin e shërbimit (pastrimi, grumbullimi dhe bartja e Llumit) këtu e më poshtë të quajtura në tërësi si shërbime, të cilësuar në nenet e kësaj Kontrate.
- Në asnjë rast nenet nuk mund të përmbajnë dispozita të cilat shkojnë në kundërshtim me dispozitat e kontratës të vendosura në pjesën e përgjithshme të saj, përveç se kur ky

---

1

ndryshim shoqërohet shprehimisht me shkrim për shfuqizim të dispozitës respektive në pjesën e përgjithshme të kontratës.

**Neni 2  
(PËRKUFIZIME)**

Në këtë Kontratë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme kanë kuptimet e dhëna më poshtë:

**KONTRATË:** çdo akord apo pajtim i vullneteve të dy a më shumë subjekteve të së drejtës, që mund të jenë persona fizik apo juridik, me të cilën synohet të arrihet ndonjë efekt juridik krijimi, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.

**AFAT:** ka kuptimin e dhënë në Nenin 4

**KRYERËSI I SHËRBIMEVE:** do të thotë: KRM "ÇABRATI" SH.A.

**POROSITËSI I SHËRBIMEVE:** do të thotë: KRU "GJAKOVA" SH.A.

**PERSONAT KONTAKTUES:** ka kuptimin e personit (Fizik, Juridik) me të cilin bëhen kontaktet në lidhje me zbatimin e mirëfilltë të kësaj kontrate.

**Neni 3  
(OBJEKTI I KONTRATËS)**

Palët kontraktuese janë marrë vesh që lënda (objekti) e kontratës të jetë: Pastrimi, grumbullimi Lymit (Llumi) të tharë nga trajtimi i ujërave të ndotura dhe bartja apo transporti deri në deponinë e Landovicës - Prizren.

**Neni 4  
(AFATI I BASHKËPUNIMI).**

4.1 Kjo Kontrate fillon në datën 30.11.2022 dhe është e vlefshme për një periudhë kohore 2 (dy) vjeçare, përkatësisht deri me datën 30.11.2024, me mundësi vazhdimi, përveç rastit kur është fjala për zgjidhje të parakohshme të kësaj kontrate, sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese.

4.2 Personat Kontaktues nga porositësi i shërbimeve, do të jenë: znj. Fjolla Lasku, tel. +383(0)49 732 859, e-mail: [fjolla.lasku@kru-gjakova.com](mailto:fjolla.lasku@kru-gjakova.com), dhe nga kryerësi i shërbimeve, z. Artan Dervishi, tel; +383(0)44 253 655, e-mail: [artan.dervishi@cabrati.com](mailto:artan.dervishi@cabrati.com), zyrtar përgjegjës për përcjelljen, kujdesin dhe menaxhimin e zbatimit të kontratës.

**Neni 5  
(TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE )**

5.1 Palët do të bashkëpunojnë dhe kryerësi i shërbimeve do të kryej shërbimet e paraqitura në objektin e kontratës dhe në nenet përkatëse të saj në përputhje edhe me specifikimet dhe që përcaktohen sipas kësaj kontrate.

5.2 Palët kontraktuese pajtohen që kryerësi i shërbimeve, KRM "ÇABRATI" Sh.A. do të kryej shërbimet sipas porosisë të cekura në këtë marrëveshje sipas porosisë nga porositësi i punës, kurse porositësi i shërbimeve, KRU "Gjakova" Sh.A., për kryerjen e punëve do të bëjë pagesën sipas fletë dërgesave, dhe faturave të pranuar nga kryerësi i shërbimeve.

- 5.3 Kryerësi i shërbimeve obligohet të bënë Kryerjen e Shërbimit ashtu siç kërkohet nga Porositësi i Shërbimit.
- 5.4 Secila palë do të sigurojë vazhdimësinë e marrëdhënies ndërmjet tyre, duke u bazuar në parimin e korrektesës në përmbushjen e detyrimeve respektive.

**Neni 6  
(ÇMIMI DHE KUSHTET E PAGESËS)**

- 6.1 KRM "ÇABRATI" Sh.A., këtu kryerësi i shërbimeve për shërbimet e bëra sipas kësaj Marrëveshjeje përmes faturës i'a faturon KRU "Gjakovës" Sh.A., këtu porositësit të shërbimeve tarifën në fund të kryerjes së shërbimit, në pajtim me tarifën e paraparë në këtë marrëveshje.
- 6.2 Faturimi do të bëhet sipas ofertës së prezantuar dhe në përputhje me çmimin e përcaktuar sipas kësaj marrëveshjeje, ku përfshihen shpenzimet operative të kryerësit të shërbimeve me 6.83 euro për Ton, si dhe çmimi i faturimit të Llumit me 0.50 euro për metër/kub, nga KMDK-Deponia Landovicë.

**Neni 7  
(LIGJI DHE JURIDIKSIONI)**

- 7.1 Kjo Kontratë qeveriset nga Ligji Kosovar, dhe është nën juridiksionin e Gjykatës Themelore të Gjakovës.
- 7.2 Në rast të çdo mosmarrëveshjeje që lind për shkak ose në lidhje me përmbushjen ose interpretimin e kësaj kontrate, Palët bien dakord të takohen dhe të negociojnë në mirëbesim për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të së cilës, vendimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes do ta marrë Gjykata Themelore e Gjakovës.
- 7.3 Kjo Kontratë hartohet dhe nënshkruhet në tre (4) kopje origjinale, nga dy (2) kopje origjinale për secilën palë kontraktuese.

NËNShKRUEt PËR DHE NË EMËR TË KRYERËSIT TË SHËRBIMEVE

*B. Ferizi*  
Z. Behar FERIZI, Kryeshf Ekzekutiv, KRM "ÇABRATI" SH.A.

Datë: 30/11/2022



NËNShKRUEt PËR DHE NË EMËR TË POROSITËSIT TË SHËRBIMEVE

*H. Krasniqi*  
Z. Hasan KRASNIQI, Kryeshf Ekzekutiv, KRU "GJAKOVA" Sh.A.,

Datë: 30/11/2022



**Shtojca 6. Zonat e ujitjes të mbuluara nga KRU "Radoniqi-Dukagjini"**



